

Shell Upstream Albania B.V.
Blv. Bopam, Cunt
ETC Building
Tirana Albania
Internet: <http://www.shell.com>

Tirane, me 7 Shtator 2018

Nr. 743 Prot

Per: Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura
Z. Zamir Dedej
Drejtor i Pergjithshem
Adresa: "Sheshi Skenderbej", Ministria Turizmit dhe Mjedisit, Tirane, Shqiperi

Lenda: Kthim pergjigje shkreses nr. 838/1 Prot. date 06.08.2018

I nderuar Z. Dedej,

Ju pergjigjemi shkreses tuaj n. 838/1 Prot. date 06.08.2018 e cila jep informacion mbi Vleresimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) per projektin e punimeve sizmike ne Bllokun-4, ne toke, Shqiperi.

Duke ju falenderuar per sugjerimet tuaja mbi keto punime sizmike, deshirojme t'ju sigurojme se "Shell Upstream Albania B.V." zbaton standartet me te larta te mbrojtjes se mjedisit gjate kryerjes se punimeve sizmike.

Ne kete kuader, ne jemi te lumtur per miratimin e Vendimit te Keshillit te Ministrave (VKM) nr. 354/2018 "Per zgjerimin dhe kthimin e parkut rajonal "Zagori" ne Park Natyror", megjithese sic nenvizohet ne shkresen tuaj disa nga linjat tona sizmike tanime gjenden brenda zones se Parkut Natyror Zagori, dhe me konkretisht linjat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7 prekin Parkun Kombetar "Bredhi i Hotoves - Dangelli", monumente te tjere natyrore si dhe Parkun Natyror "Zagori".

Duke marre ne konsiderate realitetin e ketij kuadri te ri ligjor i cili u miratua pas takimeve te para qe kemi pasur, na duhet t'ju informojme se keto linja sizmike te cilat jane te vendosura ne zonen e Parkut Natyror Zagori perbejne zonen qendrore te punimeve sizmike te Bllokut-4.

Per rrjedhoje, imazhet e struktures gjeologjike te cilat do te perftohen nga punimet sizmike ne kete zone te Parkut Natyror Zagori do te kene nje rendesi thelbesore per kompletimin e hartes gjeologjike te Bllokut-4.



Me qellim për të pasur imazhet sizmike me efektive përgjate një linje sizmike, metodat që përdoren sipas standarteve ndërkombëtare përdorin ose burime energjie impulsive ose jo-impulsive, ose një kombinim të të dyjave.

Burimet e energjisë impulsive përfshijnë plasjen e lendeve plasese të degradueshme të cilat percojnë energji në tokë në formën e një pulsimi me kohezgjatje të shkurtër. Këto lende plasese futen në puse dhe plasen në sekuenca gjatë fazës së regjistrimit. Thellessia e puseve varion nga 6 deri në 30m dhe madhësia e lendes plasese varet nga përgjigja e shtresës së nëntokës (për projektin konkret thellessia do të jetë 12m ndërsa madhësia e lendes plasese 4kg).

Në të kundërt, metoda me burim energjie jo-impulsive (vibrore) përdor makina të pajisura me pllaka vibruese të cilat levizin përgjate linjave sizmike të parapercaktuara dhe që përdorin rrugë kalimi ekzistuese ose hapin rrugë të reja. Këto makina vibrojnë në fazë dhe janë të rreshtuara sipas profilit i cili do të studiohet, dhe kanë hapësirë ndërmjet njëra tjetres me qëllim për të zbutur valet e energjisë në sipërfaqe dhe për të forcuar intensitetin e vales e cila emetohet vertikalisht.

Përzgjedhja e burimit të energjisë varet nga topografia, kushtet e terrenit dhe nga cilesia e të dhënave sizmike të cilat mund të përtohen nga këto burime marrë parasysh gjeologjinë e nën-shtresave.

Në shkresën tona të mëparshme nr. 498 prot. datë 02.07.2018 në kërni përmendur se në zonën e Parkut Natyror punimet sizmike do të konsistojnë në vendosjen e gjeofoneve të cilat do të regjistrojnë vibrimet natyrore të nën-shtresave, e quajtur ndryshe "metoda pasive". Siç është përmendur më sipër, ky përshkrim është prezantuar tek ju përpara se të viheshim në dijeni mbi permasat dhe klasifikimin e Parkut Kombëtar Zagori të miratuar nga VKM nr. 354/2018.

Në fakt, duhet të kuptohet se këto gjeofone do të regjistrojnë valet e energjisë të krijuara nga burimet e energjisë impulsive ose jo-impulsive përgjate linjës sizmike dhe brenda një diapazoni të caktuar.

Gjatesia e linjës sizmike e cila prek Parkun Kombëtar "Bredhi i Hotoves – Dangelli" është rregulluar në atë mënyrë që vetëm gjeofone (jo burime energjie sizmike) do të shtrihen në zonën e këtij Parku Kombëtar, por me kushtin që të përdoren burime energjie sizmike përgjate pjesës tjetër të linjave sizmike, në rastin konkret përgjate Parkut Natyror Zagori.

Në punime sizmike është e pamundur marrja e suksesshme e imazheve të dobishme sizmike vetëm duke përdorur "metodën sizmike pasive" përgjate gjithë gjatësisë së linjës sizmike, sepse kjo gjë nuk do të sillte informacionin e mjaftueshëm.

Për rrjedhojë, udhezimi juaj i përcjelle me shkresën tuaj nr. 838/1 Prot. datë 06.08.2018 për mos lejimin e metodave të tjera të punimeve sizmike përveç "metodës së sizmikes pasive", nuk është i përshtatshëm për permasat dhe shtrirjen e programit tona të punimeve sizmike duke marrë në konsideratë zonën e Parkut Natyror Zagori i cili mbulon thuajse totalisht disa nga këto linja (linja 14) dhe do të krijojë boshllëqe në imazhet sizmike të cilat do të ishin shumë të mëdha për të kryer një interpretim sizmik (linjat 11, 12, 17).

Ndaj në praktike, përdorimi i burimeve të energjisë impulsive ose jo-impulsive është i nevojshëm përgjate gjithë gjatësisë së linjës sizmike me përjashtim të skajeve fundore të saj ku shtrihen vetëm gjeofone.